



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (KFZ)

NË RAST

OPERACIONI/ INCIDENTI KËRKIM SHPËTIMI NË HAPËSIRËN

E PËRGJËGJËSISË SË KFZ

Tiranë, 2024



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ

Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtitimit

Nr 186 Prot, datë 13 / Maj / 2024

Kukës International Airport SHPK

Nr 94 Prot, datë 13 / Maj / 2024

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË MBROJTJES SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (KFZ)

NË RAST

OPERACIONI KËRKIM SHPËTIMI NË ZONËN E PËRGJEGJËSISË SË KFZ

HYRJE

Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi (në vijim referuar si ("Memorandumi")) është hartuar nga dhe ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtitimit (QKKSH) në Ministrinë e Mbrotjes në RSH (në vijim referuar si "QKKSH") dhe Kukës International Airport SHPK (KFZ), (në vijim referuar si "KFZ"). Së bashku në vijim referuar si "Palët".

Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtitimit dhe detyrimet e Republikës së Shqipërisë përkohë shërbim përcaktohen nga konventat ndërkombëtare dhe aktet ligjore e nënligjore të ratifikuara e miratuara nga autoritetet e vendit tonë.

Në kontekstin e përfaqësimit të tyre ligjor dhe institucional në mbështetje të legjislacionit në fuqi (kombëtar dhe ndërkombëtar) për menaxhimin, koordinimin dhe kryerjen e operacioneve të Kërkim Shpëtitimit (Search And Rescue-SAR) në hapësirën e përgjegjësisë së KFZ-së.

Duke njohur nevojën e bashkëpunimit për arrijen e objektivave primare të tyre të cilat janë shpëtimi i jetës njerëzore në rast të një aksidenti SAR. Duke menduar se një Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi do të ndihmojë në zgjidhjen e situatave operacionale të përbashkëta në mënyrën më efikase të mundshme.

Duke mbajtur parasysh referencat e mëposhtme ligjore:

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

Faqe 2 of 9

- Aneksi 12 “Kërkim-Shpëtimi” i Konventës Ndërkontaktore të Avacionit Civil të ICAO-s (Organizatës Ndërkontaktore të Avacionit Civil), Çikago 1944);
- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 20.3.2019 është miratuar Kontrata e Koncesionit/partneritet publik privat, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Global Technical Mechanics” sh.p.k dhe “Bami” sh.p.k. si koncessionari dhe shoqërisë koncessionare “Kukës International Airport” sh.p.k, për rehabilitimin, operimin, transferimin e Aeroportit të Kukësit;
- Ligi Nr. 96/2020 Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligi Nr.10435, datë 23.06.2011 “Për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në RSH”;
- Vendimi Nr.575, datë 10.08.2011 “Për miratimin e programit kombëtar të Sigurisë së Avacionit Civil (PKSAC)”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.729, datë 13.11.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të tij”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.742, datë 16.10.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit”;
- Manuali i Operimit të Shërbimeve të Trafikut Ajror shqiptar;
- Programi i Sigurisë së Aeroportit;
- Plani i Emergjencave të Aeroportit;

DUKE QENE SE:

- (i) Marrëveshja e Koncesionit parashikon se KFZ gjëzon të drejtën, fuqinë dhe autoritetin për të kryer, ndërmjet të tjerave, mirëmbajtjen, operimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Aeroportit;
- (ii) Palët ndajnë vizionin e mundësimit të forcimit të bashkëpunimit në lidhje me përmirësimin e sigurisë teknike dhe një përgjigje të shpejtë të aktiviteteve të Kërkim-Shpëtimit që do të kryhen në Zonën e Koncesionit;
- (iii) Misioni i QKKSH-së është menaxhimi dhe koordinimi i operacioneve të kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe ajrore të Republikës së Shqipërisë, në rast të fatkeqësive të ndryshme, duke ndërrhyrë, këruar, gjetur dhe shpëtuar persona të humbur dhe të zhdukur kur jeta njerëzore është në rrezik;

KFZ dhe QKKSH, angazhohen plotësisht për zbatimin e kushteve të parashikuara në këtë Memorandum.

Të dyja palët janë të detyruara të koordinojnë ndërmjet tyre për çdo ndryshim të statusit operacional apo të mjeteve të tyre të operimit, të cilat ndikojnë në procedurat e specifikuara në këtë Marrëveshje Teknike.




PËR KËTË ARSYE, Palët bien dakord si më poshtë:

Përkuvizime

Përkuvizimet e mëposhtme do të aplikohen në këtë Memorandum:

“Aeroport”	do të ketë kuptimin e përcaktuar në Marrëveshjen e Koncesionit
“Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit (SAR)”	është Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.
“Kërkim”,	Një operacion, zakonisht i koordinuar nga një qendër e koordinimit të shpëtimit apo një nënqendër e shpëtimit, duke përdorur personelin dhe mjetet në dispozicion për të gjetur personat në rrezik. (Aneksi 12 i ICAO-s)
“Shpëtim”	Një operacioni i zhvendosjes/i marres së personave në rrezik, mbështetja e tyre me nevojat bazë mjekësore ose nevoja të tjera, si dhe dërgimi i tyre në një vend të sigurt. (Aneksi 12 i ICAO-s)
“Rast kërkim-shpëtimi”	Çdo fatkeqësi e mundshme apo që ka ndodhur për të cilën një strukturë SAR ka krijuar një dosje dokumentesh, megjithëse burimet SAR nuk janë aktivizuar.
“Incident kërkim-shpëtimi”	Çdo situatë që kërkon informimin dhe njoftimin e sistemit SAR dhe që mund të kërkojë zhvillimin, menaxhimin dhe koordinimin e operacionit SAR.
“Qendra koordinimit shpëtimi” e të	Qendra nga e cila një incident SAR kontrollohet dhe koordinohet. Kjo qendër njihet me terma të ndryshëm të tillë, si Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, Zyra e Incidenteve Madhore, Zyra e Operacioneve. Për qëllimet e këtij Memorandumi, këto qendër quhet Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimi (QKKSH) ose RCC.
“Njësia e kërkimit dhe e shpëtimit”	Një njësi e përbërë nga personeli i trajnuar mirë dhe i pajisur me pajisje të përshtatshme për kryerjen e shpejtë të operacioneve të kërkim-shpëtimit.
“Koordinimi”	Bashkimi i strukturave dhe elementeve SAR, për të siguruar përgjigje efikase të kërkim-shpëtimit. Një njësi SAR duhet gjithmonë të ketë përgjegjësinë e përgjithshme të koordinimit dhe strukturat e tjera duhet të bashkëpunojnë me këtë njësi për të dhënë përgjigen më të mirë të mundshme me burimet që kanë dispozicion.
“Vendngjarje”	Zonë kërkimi ose zona ku do të kryhen operacionet e shpëtimit.



“Koordinator në Vendngjarje”	Një person i caktuar për të koordinuar operacionet e kërkimit dhe të shpëtimit brenda një zone të specifikuar.
“Komunikimet koordinuese të kërkim-shpëtimit”	Komunikimet e nevojshme për koordinimin e strukturave që marrin pjesë në një operacion të kërkimit dhe të shpëtimit.
“Zona e përgjegjësisë së KFZ”	Pjesa e brendshme e një rrathi me rreze 5 milje/8 km nga pika e referencës së aerodromit (Aerodrome Reference Point-ARP), apo siç mund të ndryshohet në çdo kohë në Rregulloret Kombëtare.

Neni 1

Objekti i Memoradumit

1.1 Qëllimi i këtij Memorandumi është njojja e ndërsjelltë e detyrimeve dhe lehtësimi i procedurave të përbashkëta të koordinimit dhe bashkëpunimit në menaxhimin e operacioneve SAR dhe domosdoshmëria e zbatimit të tyre në rast operacioni në zonën e përgjegjësisë së KFZ-s për kërkim-shpëtimin e jetës njerëzore.

Neni 2

Kohëzgjatja


- 2.1 Kohëzgjatja e këtij Memorandumi fillon në datën e nënshkrimit më të fundit të tij nga të dyja palët dhe do të jetë efektiv për një periudhë 3 (tre) vjecare.
- 2.2 Memorandumi mund të zgjidhet në çdo kohë nga seila Palë. Zgjidhja e Memorandumit do të jetë efektive në momentin që njëra Palë njofton Palën tjetër përkatësisht në formë të shkruar 3 (tre) muaj në advancë, në rast se njoftimi në fjalë për zgjidhje të Memorandumit nuk është térhequr/anulluar me miratimin e Palëve përpërfundimit të kësaj periudhe.

Neni 3

Të Drejtat dhe Detyrimet e të dyja Palëve

3.1 Përgjegjësitet e QKKSH-së


- Koordinon në nivelin më të lartë kombëtar operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë;
- Bashkërendon komunikimet koordinuese të kërkim-shpëtimit me KFZ-n, gjatë kryerjes së operacioneve të kërkim-shpëtimit, në përputhje me legjislacionin e miratuar për shërbimin e kërkim-shpëtimit në RSH.
- Është pikë kombëtare kontakti për operacionet e kërkim-shpëtimit. Ajo bashkëvepron me institucionet shtetërore, entet private dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe është përgjigjëse për detyrimet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit në zonën e përgjegjësisë.



- Ndhimon dhe koordinon veprimet me autoritetet e KFZ në rast të një incidenti brenda zonës së përgjegjësisë së aeroportit, në përputhje me kushtet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në planin e Emergjencës së Aeroportit, me qëllim koordinimin e operacioneve të shërbimit të kërkim shpëtimit brenda kësaj zone.
- Merr pjesë në stërvitje të përbashkëta të organizuara nga KFZ në kuadër të operacioneve të shërbimit të kërkim-shpëtimit.
- Njofton KFZ-në në rast se ndonjë operacion SAR zhvillohet jashtë rrithimit të perimetrit dhe brenda zonës së përgjegjësisë së KFZ-s (në km, sic është shprehur në AEP (Planin e Emergjencave të Aeroportit)).
- Me kërkeshë të KFZ, koordinon kapacitete operacionale të shërbimit të kërkim shpëtimit në lidhje me avionët që janë në rrezik, dhe në rast aksidenti ose incidenti drejton në vendngjarje njësinë e nevojshme të shpëtimit sa më shpejt të jetë e mundur, pasi të jetë koordinuar me autoritete e KFZ-s.
- QKKSH duhet të ketë në dispozicion në çdo moment informacione të qarta përsa i përket Rajonit të Kërkimit dhe Shpëtimit (FIR).
- Menaxhon dhe Koordinon Njësitë e Kërkim-Shpëtimit në operacionet SAR në afërsi të zonës së përgjegjësisë së KFZ. Në rast hetimesh, bashkëpunon me KFZ-n dhe autoritetet kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim shkëmbimin e të dhënave të mbledhura.

3.2 Përgjegjësitë e Kukës International Airport (KFZ)

- Në rast incidenti kërkim-shpëtimi SAR në zonën e saj të përgjegjësisë (në km sipas AEP), KFZ do të vërë në zbatim Planin e Emergjencave të Aeroportit, Airport Emergency Plan (AEP).
- Në rast të një incidenti kërkim-shpëtimi SAR brenda zonës së saj të përgjegjësisë, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit ndërmerr nga autoritetet KFZ.
- Koordinon me QKKSH për të aktivizuar nga ana e saj kapacitete operacionale në rast të një incidenti kërkim shpëtimi SAR në zonën e saj të përgjegjësisë nga perimetri rrethues i aeroportit deri në një rrëze prej aq km si në Planin e Emergjencave të Aeroportit.
- Në zbatim të rregullave dhe kërkeseve Kombëtare dhe Ndërkombëtare, KFZ si operatore e aeroportit, është përgjegjësja e vetme, për tu përgjigjur dhe kryer operacione të zjarrfikjesh dhe shpëtimi në të gjitha aksidentet dhe incidentet që ndodhin brenda perimetrit të rrithimit të Aeroportit.
- Merr pjesë në stërvitje të përbashkëta të organizuara nga QKKSH me njoftimin e këtij të fundit.
- Në rast të ndonjë operacioni SAR, brenda kufijve të zonës së përgjegjësisë së KFZ, KFZ do të mbështesë QKKSH-n duke i vënë në dispozicion kapacitetet që ajo ka, më kërkeshë të QKKSH-së.
- Në rast hetimesh të një Incidenti Kërkim-Shpëtimi SAR, bashkëpunon dhe shkëmbej të dhënat e mbledhura me QKKSH dhe autoritetet kompetente kombëtare e ndërkombëtare.
- Në rast incidenti kërkim-shpëtimi në afërsi të zonës së përgjegjësisë së KFZ, mban kontakte me Koordinatorin në Vendngjarje.



- Krijon një databazë për çdo rast kërkim-shpëtimi SAR në zonën e saj të përgjegjësisë.
- Ndan Informacion me QKKSH-në për kapacitetet SAR të cilat KFZ disponon.

Neni 4

Bashkëpunimi

- 4.1 Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të bashkëpunuar dhe përbushur të gjitha detyrimet sipas këtij Memorandumi me të gjithë kujdesin e duhur si dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit të Koncessionit, si dhe standartet dhe rekomandimet Shqiptare dhe ato ndërkombëtare.

Neni 5

Forca Madhore

- 5.1 As KFZ dhe as QKKSH nuk do të mbajnë përgjegjësi për ndonjë mospërbushje apo vonesë në përbushjen e kushteve të këtij Memorandumi për arsyen e Forcës Madhore. Është rënë dakord në mënyrë specifike se shkaqet e Forcës Madhore janë të pranueshme vetëm për të përcaktuar vonesat me zgjatjen proporcionale të afatit kohor dhe jo si bazë për kompensimin e secilës palë.

Neni 6

Transferimi i të Drejtave

- 6.1 Palët, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, nuk do të transferojnë, delegojnë apo kalojnë në ndonjë formë tjeter ndonjë të drejtë apo detyrim sipas këtij Memorandumi ose ndonjë interes apo pretendim përkatës, në tërësi apo pjesërisht, pa miratimin paraprak në formë të shkruar të palëve (KFZ dhe QKKSH), si dhe çdo përpjekje për transferimin e kryer pa miratimin paraprak në formë të shkruar si më sipër, do të jetë i pavlefshëm dhe nuk do të ketë asnjë fuqi apo efekt ligjor.

Neni 7

Amendamentet

- 7.1 Memorandumi përbën të gjithë mirëkuptimin e Palëve dhe asnjë kusht, detyrim, mirëkuptim apo marrëveshje e cila ka për qëllim të modifikojë kushtet e këtij Memorandumi nuk do të jetë i detyrueshëm për t'u zbatuar përvèç rasteve kur bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

Neni 8

Memorandumi si i tërë

- 8.1 Memorandumi do të interpretohet duke marrë në konsideratë kushtet dhe detyrimet e tij në tërësi. Në çdo rast, çdo klauzolë apo citim i cili mund të krijojë pasiguri duhet të konsiderohet në kontekstin e të gjithë Memorandumit dhe në



kontekstin e qëllimeve në bazë të të cilave Palët kanë nënshkruar këtë Memorandum.

Neni 9

Njoftimet dhe komunikimet

Çdo njoftim, aplikim apo komunikim në ndonjë formë tjetër sipas apo në lidhje me këtë Memorandum do të bëhet në formë të shkruar. Komunikimet e përditshme sipas këtij Memorandumi do të bëhen në gjuhën Shqipe.

Çdo njoftim, aplikim apo komunikim do të bëhet në formë të shkruar dhe do të dërgohet dorazi, nëpërmjet postës apo faksit në adresat e mëposhtme:

KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT SHPK

Administratori

Ridgers Mema

Kukës International Airport

Ndërtesa e Terminalit, Shtiqen, Kukës Albania

Në vëmendje të: Z. Altin Janku

Menaxheri i Shërbimeve Aeroportuale

Tel.: +355696827655

E-mail: operations@kuiport.al

Z. Jorgo Kokori

Shefi i RFFS

Tel.: +355 697337222

+355 682065025

MINISTRIA E MBROJTJES

QENDRA KOMBËTARE E KËRKIM-SHPËTIMIT

“Rruga e Dibrës”

Ndërtesa e Shtabit të Pëgjithshëm të FA

Mob: 0688046638

Tel: 042240081

FAX:042240087

E-mail: nsarc@aaf.mil.al

Neni 10

Konfidencialiteti

Secila Palë do të ndërmarrë të gjitha masat paraprake të përgjegjësisë të nevojshme për të mbrojtur informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi nga bërrja publike në formë të paautorizuar. Palët bien dakord të mbikëqyrin, në masën e kërkuar sipas legjislacionit të aplikueshëm, rregullat dhe rregulloret e tyre përkatëse, mbrojtjen e informacionit të marrë nga Pala tjetër.

Palët janë të detyruara të respektojnë nenin e Konfidencialitet edhe pas përfundimit të këtij Memorandumi

Neni 11

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

Faqe 8 of 9

Dispozita Përfundimtare


- 11.1 Të gjitha dokumentet, nëse ka, të shkëmbyera më parë mes tyre, si dhe çdo diskutim dhe marrëveshje të bërë më parë dhe të lidhur ndërmjet tyre, të cilat nuk janë përcaktuar në Memorandum, konsiderohen të pavlefshme dhe nuk kanë asnjë efekt ligjor dhe nuk do të merren në asnjë mënyrë në konsideratë në zbatimin e kushteve të këtij Memorandumi.
- 11.2 Ky Memorandum përbën një shprehje përfundimtare në formë të shkruar të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të tij dhe është një deklaratë e plotë dhe ekskluzive e këtyre kushteve dhe detyrimeve.
- 11.3 Të gjithë titujt e kapitujve të përdorur në këtë Memorandum janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e këtij Memorandumi.
- 11.4 Asnjë ndryshim, plotësim ose modifikim tjetër i këtij Memorandumi nuk do të jetë efektiv nëse nuk është në formë të shkruar, nuk i referohet në mënyrë specifike Memorandumit dhe nuk nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të secilës Palë.
- 11.5 Ky Memorandum është hartuar në gjuhën Shqipe në dy kopje origjinale për secilën palë.

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e tij përkatëse të nënshkrimit.

Tiranë, më ____ / ____ / 2024

PËR MINISTRINË E MBROJTJES

(Referuar Autorizimit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1859, datë 29/3/2021)


KOLONEL FIQIRI HOXHA


KRYETAR I QENDRËS KOMBËTARE
TË KËRKIM SHPËTIMIT



PËR KUKËS INTERNATIONAL

AIRPORT SHPK


ZOTI RIDGERS MEMA


DREJTORI PËRGJITHSHËM
EKZEKUTIV